



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:097788
Datë: 21.03.2024
Numri i dokumentit: 05485532

Ac.nr.2806/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Feka-Kryetar i Kolegjit, Arsim Hamzaj dhe Frosina Sylejmani, antarë të kolegjit, në çështjen juridiko- kontestimore të paditëses B. K. e S. (BKS) me seli në P., Rr. xxxx, magjistratja Prishtinë-Fushë Kosovë, të cilën me autorizim e përfaqëson B. B., kundër të paditurit L. Z. nga fshati D., Komuna Sh., për rimbursim dëmi, duke vendosur sipas ankesës së ushtruar nga i padituri kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm C.nr. 614/17, të datës 08.03.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **21.03.2024**, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET SI E PA BAZUAR ankesa e të paditurit L. Z. nga fshati D., Komuna e Sh., ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm me numër C.nr.614/17, i datës 08.03.2022, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i përgjithshëm me aktgjykimin C.nr.614/17, të datës 08.03.2021, ka vendosur si në vijim:

I. APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditëses B. K. e S. (BKS) me seli në P., si e bazuar.

II. DETYROHET i padituri L. Z. nga fshati D., Komuna Sh., që paditëses B. K. e S. (BKS) me seli në P., t'ia paguan shumën prej 730.00 euro (shtatëqind e tridhjetë euro) në emër të rimbursimit të pagesës për kompensimin e dëmit lidhur me aksidentin e datës 12.02.2014, të shkaktuar nga i padituri, me kamatën ligjore prej 8%, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 20.00 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit të përcaktuar ligjor, ankesë ka paraqitur i padituri, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar, ta ndyshojë aktgjykimin e atakaur duke e refuzuar në tërësi si të pa bazuar kërkespadinë e paditësit.

Paditësi nuk ka ushtruar përgjegje në ankesë.

Gjykata e Apelit, si gjykatë ankimore, pas shqyrtimit të ankesës, pretendimeve ankimore, vlerësimit dhe analizimit të provave në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 194, 195 paragrafi 1 pika (d) në lidhje me nenin 200 të LPK-së, konstatoi se:

Ankesa e të paditurit L. Z. nga fshati D., Komuna Sh. është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja B. K. e S. (BKS) me seli në P., Rr. xxxx magjistranja Prishtinë-Fushë Kosovë, përmes përfaqësueses së saj të autorizuar B. B., me datë 28.07.2017 ka paraqitur padi për rimbursim dëmi ndaj paditësit L. Z. nga fshati D., Komuna Sh.. E paditura i ka propozuar gjykatës që ta detyrojë të paditurin t'ia rimbursoj dëmin në shumën prej 730.00 euro në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 12.02.2014, ku shkaktar i aksidentit ishte padituri, i cili në momentin e shkaktimit të aksidentit, ka qenë duke vozitur pa mbulesë sigurimi, respektivisht me policë të skaduar të sigurimit, nga i cili aksident kanë pësuar dëme materiale dhe jo-materiale i dëmtuari F. G.

I padituri në përgjigjen e tij në padi, ka deklaruar se është e vërtetë se ka shkaktuar aksidentin në fjalë, por thekson se aksidentit i ka kontribuar edhe pala e dëmtuar, e po ashtu thekson se dëmet materiale kanë qenë shumë të vogla, ndërsa shuma të cilën paditësja ia ka kompensuar të dëmtuarit e të cilën tani kërkon ti rimbursohet nga i paditur, është shumë tejet e lartë e cila nuk përkon me dëmet e shkaktuar në këtë aksident.

Gjykata e shkallës së parë, ka mbajtur seancave gjyqësore dhe pas nxjerrjes dhe administrimit të provave ka nxjerr aktgjykimin e ankimuar me vendosje më të hollësishme si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në arsyetim të aktgjykimin të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se përmes raportit policor, gjykata ka konstatuar faktin se i padituri ka shkaktuar aksident komunikacioni dhe në momentin e aksidentit ka qenë duke vozitur pa mbulesë siguruese, respektivisht me policë të skaduar të sigurimit, nga i cili aksident kanë pësuar dëme materiale në veturë i dëmtuari Flamur Groza nga Gjakova. Përmes procesverbalit për vlerësimin e dëmit të veturës dhe faturave të paguara, gjykata vërtetoi faktin se dëmin material në veturë, të pësuar nga aksidenti i trafikut,

organet përkatëse të paditëses e kanë vlerësuar në lartësi prej 730.00 euro. Shumat kërkuara nga paditësja në emër të rimbursimit të demit përputhen plotësisht me shumat e paguara nga paditësja për të dëmtuarin në emër të kompensimit të demit material, të pësuar nga aksidenti i shkakuar me fajin e të paditurit. Andaj, gjykata e aprovoi në tërësi si të themeltë kërkespadinë e paditëses duke e mbështet vednimin e saj në nenin 18 paragrafi 4 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia. Në raport me kamatën, gjykata vendimine mori bazuar në nenin 382 të LMD-së, ndërsa sa i përket shpenzimeve të procedurës vendosi sipas nenit 452 paragrafi 1 të LMD-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar me ankesë nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, dhe as shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, par.2, pika n) të pretenduara nga pala ankuese, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht dhe se drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë.

Sa i përket pretendimeve ankimore të të paditurës, gjykata e shkallës së dytë vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës së paditur se gjykata e shkallës së parë me rastin e nxjerrjes së aktgjykimit të ankimuar ka bërë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2, pika n), ngase nga nga përmbajtja dhe struktura e aktgjykimit të ankimuar, konstatohet se gjykata e shkallës së parë ka harmonizuar në tërësi përmbajtjen e arsytimit me dispozitivin dhe se e njëjta ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare të cilat kanë rezultuar me aprovimin e kërkesëpadisë së paditëses, andaj ky pretendim ankimor rezulton i pa bazuar.

Gjykata e Apelit e refuzon si të pa bazë pretendimin ankimor të palës së paditur e cila në ankesë thekson se gjykata e shkallës së parë ka shkelur parimin e kontradiktorialitetit e kjo për faktin se nga shkesat e lëndës, konkretisht nga parashtesa C.Nr.614/17 e datës 14.08.2017, vërtetohet se të paditurit iu është dërguar padia me udhëzimin që i padituri të jep përgjegjje me shkrim për sa i përket padisë në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit të padisë me kërcënimin e dhënies së aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë në kuptimin e nenit 150 të LPK-së. I padituri, përmes parashtrësës së datës 19.09.2017 ka dhënë përgjegjje në padi duke e kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar. Tutje, i padituri, përmes fletë dërgesës të datës 01.10.2021 është ftuar në mënyrë të rregullt për në seancën kryesore e cila është mbajtur me datë 08.12.2021. Fletë dërgesa është e pranuar dhe nënshkruar nga i padituri, megjithatë, i padituri ka munguar në seancën kryesore dhe mungesën e tij nuk e ka arsytuar dhe as nuk ka kërkuar që seanca të shtyhet për një datë tjetër, ndërsa edhe përmes ankesës e ka pohuar faktin se ka qenë i ftuar për në seancë kryesore por nga ka prezentuar në seancë për shkak të ngarkesës së madhe të punës, andaj Gjykata e Apelit thekson se gjykata e shkallës së parë nuk e ka shkelur parimin e kontradiktorialitetit në rastin konkret dhe ka vendosur drejt dhe në mënyrë të ligjshme konform nenit 423 paragrafi 4 i LPK-së ku parashihet se *“Po që se në seancën për shqyrtim kryesor nuk vjen i padituri që është thirrur rregullisht, atëherë shqyrtimi kryesor i çështjes bëhet pa praninë e tij”*.

Përfundimisht, Gjykata e Apelit e refuzon si të pathemeltë edhe pretendimin ankimor të palës së paditur e cila në ankesë thekson se kërkesëpadia e paditësit është e parashkruar në kuptim të nenit 357 të LMD-së, për faktin se i padituri ka patur mundësin që të thirret në institutin e parashkrimit me rastin e dhënies së përgjegjjes në padi me datë 19.09.2017, megjithatë nuk e kontestuar kërkesëpadinë e paditëses mbi bazën e parashkrimit, ndërsa sipas nenit 180 paragrafi 3 të LPK-së *“Prapësimi i parashkrimit dhe prapësimi me qëllim kompensimi, që nuk janë paraqitur në gjykimin e shkallës së parë, nuk mund të paraqiten me ankesë”*.

Gjykata e Apelit, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, mbi bazën e gjendjes së vërtetuar faktike, drejtë ka zbatuar edhe të drejtën materiale sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë përderisa baza juridike e të njëjtës nuk ishte kontestuese kur me rastin e vendosjes, i është referuar nenit 18 paragrafi 4 të Ligjit për Sigurimin nga Autopërgjegjësia nr. 04/L-118 ku përcaktohet detyrimi i siguruesit që në rastet e paraqitjes së rastit të siguruar të paraqitur nga aksidenti i komunikacionit me mjet motorik, të kompensoj dëmin e pësuar palët e treta pa fajin e tyre, e në rastin konkret, përderisa i padituri ka ngarë automjetin pa mbulesë siguruese, respektivisht me policë të skaduar të sigurimit, atëherë, përgjegjësia për kompensim të dëmit sipas nenit 18 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Sigurimin nga Autopërgjegjësia nr. 04/L-118, bie mbi këtu të paditurën Byronë Kosovare të Sigurimeve ndërsa sipas paragrafit 4 të nenit 18 të Ligjit për Sigurimin nga Autopërgjegjësia *“Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat”*, ndërsa sa i përket lartësisë së dëmit material të gjykuar nga gjykata e shkallës së parë, e njëjta ka vendosur drejtë ngase me nenin 169 paragrafi 1 dhe 3, në lidhje me nenin 173 paragrafi 1 ku përcaktohet e drejta e të dëmtuarit që në rastet e pamundësisë së kthimit në gjendje të mëparshme për dëmin material, shpërblimi të njëjtit ti ipet në të holla, dhe se gjykata e shkallës së parë, duke marrë për bazë të mirat e cenuara në rastin konkret drejtë dhe në proporcion ka caktuar kompensimin e dëmit material si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ashtu siç është vërtetuar edhe me fatura përkatëse nga ana e paditëses, e të cilat shpenzime drejtë dhe në mënyre të saktë i janë njohur paditëses.

Gjithashtu, sa i përket pretendimit ankimor të të paditurit se kërkesëpadia e paditëses është e parashkruar për faktin se nga data e pagesës së të dëmtuarës paditësjë me datën 12.02.2014 e gjer me datën 28.07.2017, kanë kaluar më tepër se tri vite, gjykata e shkallës së dytë, këtë pretendim ankimor e hudhë poshtë si të palejuar, për faktin se i padituri gjatë gjykimit në gjykatën e shkallës së parë me dhënien e përgjegjjes në padi me datën 19.09.2017, nuk e ka invokuar prapësimin material se kërkesëpadia e paditëses është e parashkruar, e këtë prapësim nuk e ka ushtruar as në seanca gjyqësore që janë mbajtur në gjykatën e shkallës së parë për të cilat nga provat në shkresat e lëndës konstatohet se i padituri është ftuar me rregull dhe mungesën nuk e ka arsyetuar, ashtu që, konform nenit 180 par.3 të Ligjit për Procedurë Kontestimore nr. 03/L-006, përcaktohet se citoj *“ Prapësimi i parashkrimit dhe prapësimi me qëllim kompensimi, që nuk janë paraqitur në gjykimin e shkallës së parë, nuk mund të paraqiten me ankesë”*, parashtruesi i ankesës në këtë rast i padituri nuk mund të invokoj apo thirret në parashkrim të kërkesës në fazën ankimore, poqëse këtë prapësim nuk e ka invokuar gjatë gjykimit të gjykatës së shkallës së parë, prandaj, në rastin konkret, i njëjti pretendim ankimor nuk mund të merret parasysh në vlerësim të pretendimeve ankimore.

Gjithashtu, sa i përket kamatëvonesës, gjykata e shkallës së parë, drejtë ka aplikuar të drejtën materiale, ku i është referuar nenit 382 par.1 dhe 2 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077, si dhe momentit të përcaktimit të rrjedhjes së saj, dhe kjo vendosje pranohet edhe nga gjykata e shkallës së dytë, ngase është në përputhje edhe me Mendimin Juridik për Kamatën të miratuar nga Gjykata Supreme e Kosovës nr. 265/20, datës 01.12.2020, gjegjësisht pikën II, V dhe XIV dhe XV të këtij mendimi, ku përcaktohet ligji i aplikueshëm, shkalla e kamatëvonesës dhe periudha e rrjedhjes së saj dhe vendosja nga gjykata e shkallës së parë është në përputhje me këto pika, ka gjykuar shkallën e kamatëvonesës prej 8% vjetore nga data e ushtrimit të padisë për dëmin material ndërsa për dëmin jo material nga data e nxjerrjes së aktgjykimit nga gjykata e shkallës së parë, e të cilën vendosje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës gjykata ka vendosur në mënyrë të duhur sepse i ka arsyetuar shpenzimet e gjykuara për secilin veprim të ndërmarrë në procedurën kontestimore, e të cilat veprime edhe sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit kanë qenë të domosdoshme në mënyrë që gjykata të vendosë për themelësinë e kërkesëpadisë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme. Lartësia është në përputhje me tarifën për përfaqësim dhe po ashtu në përputhje me tarifën për taksa gjyqësore dhe ekspertiza. Pala e paditur është obliguar për pagesën e shpenzimeve procedurale bazuar në dispozitën ligjore të nenit 452 paragrafi 1 të LPK së ku parashihet se *“pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtare gjyq fituese, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t’ia shpërblej të gjitha shpenzimet gjyqësore”*.

Nga sa u tha më lartë, Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 194, 195 paragrafi 1 pika (d) lidhur me nenin 200 të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AC.nr. 2806/22, data 21.03.2024

Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari
Besnik Feka